



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVA BASKETBALL FEDERATION
KOSARKASKA FEDERACIJA KOSOVA



KOMISIONI I GARAVE
FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO
2022-23
Prishtinë, 18/10/2022


Nr. 581 Dt. 18.10.2022
PRISHTINË • PRISHTINA • PRISTINA

VENDIM Nr. 4/2022

Komisioni i Garave i Federatës së Basketbollit të Kosovës, në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të Federatës së Basketbollit të Kosovës, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e vet të mbajtur në datën e lartpërmendur, në përbërje të plotë prej Kryesuesit Leart Hoxha dhe anëtarëve Valdet Spahija dhe Ylli Hoti, shqyrtoi dhe unanimisht miratoi këto vendime dhe rekomandime:

1. Miratohet kërkesa e KB Trepça për udhëtim të organizuar të tifozëve të këtij klubi në ndeshje e xhiros VII me KB Vëllaznimi. Urdhërohen KB Vëllaznimi dhe KB Trepça të veprojnë sipas dispozitave të nenit 10 të Propozicioneve të Garave.
2. Komisioni ka shqyrtuar situatën me obligime të pashlyera financiare të klubeve ndaj FBK-së. Komisioni kërkon nga zyra e FBK-së që deri më datën 25.10.2022 të përgatisë raportin e plotë të borxheve të pashlyera të klubeve. Komisioni njëkohësisht njofton klubet se në rast se nuk do të shlyejnë obligimet ndaj FBK-së, para fillimit të xhiros së radhës pas përpilimit të raportit (xhiro VIII), do të suspendohen nga garat.

Në emër të Komisionit të Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës:


Leart Hoxha
Kryesues i Komisionit

KËSHILLË JURIDIKE:

Palët e pakënaqura me Vendimet e Komisionit të Garave mund të parashtrojnë ankesë pranë Komisionit Arbitrar të FBK-së, në formën dhe brenda afateve të përcaktuara me aktet normative të FBK-së.

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Local Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVA BASKETBALL FEDERATION
KOSARKASKA FEDERACIJA KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 581 Dt. 18.10.2022
PRISHTINË • PRIŠTINA • PRISTINA

ARSYETIMI I KOMISIONIT TË GARAVE VENDIMI Nr. 4/2022

Gjatë vendimmarrjes lidhur me pikën 1 të Vendimit Nr.4/2022, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

I: KB Trepça ka dërguar me kohë kërkesën për rezervim të biletave dhe udhëtim të shikuesve mysafir në mënyrë të organizuar.

II: Në komunikim me anëtarë të Komisionit të Garave zyrtarë të KB Vëllaznimi, kanë shprehur brengën e tyre për situatën e sigurisë, por nuk kanë argumentuar dhe nuk kanë dhënë dëshmi nga organet e sigurisë, se udhëtimi i tifozëve mysafir në atë ndeshje paraqet rrezik të lartë.

III: Kemi pasur edhe praktika tjera të udhëtimit të tifozëve mysafirë në ndeshje.

Gjatë vendimmarrjes lidhur me pikën 2 të Vendimit Nr.4/2022, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

I: Klubet që nuk i kanë përmbushur plotësisht kriteret për licencim, kanë bërë marrëveshje me FBK-në për shlyerje graduale të obligimeve dhe kanë pranuar kushtet që dalin nga ato marrëveshje. Po ashtu klubet ndërkohë kanë bërë edhe shpenzime tjera (transfere, dënime, gabime teknike etj).

II: Raportet financiare që përgatiten për Bordin e FBK-së tregojnë për vonesë të klubeve në përmbushjen e obligimeve dhe Komisioni kërkon që pas një ciklusi të ndeshjeve (7 xhiro), të bëhet raport i plotë nga zyra e FBK-së dhe të mos nisë ciklusi i dytë i ndeshjeve (nga xhiro VIII), me obligime të pashlyera të klubeve.



Supported by:



General Sponsor:



Coffee Sponsors:



Silver Sponsors:



Friend Basketball supporters:

